VENDIM
Nr. 146, datë 26.10.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E PËRDITËSIMIT TË APLIKIMIT TË TARIFAVE TË "CEZ SHPËRNDARJE" SHA PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 80, datë 26.6.2008 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. për rishikimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga "CEZ Shpërndarje" sh.a., për konsumatorët tariforë, për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014, në zbatim të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike",

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përditësimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për "CEZ Shpërndarje" sh.a. për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014 në zbatim të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike".
2. Fillimin e procedurave për përditësimin e tarifës të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga "CEZ Shpërndarje" sh.a. për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014, në zbatim të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shitjes me pakicë për klientët tariforë".
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e "CEZ Shpërndarje" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani